

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 24 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Vendi ynë ditë më parë u përfshi nga protestat mbarëqytetare, ku njerëzit mbushën sheshet, duke ngritur zërin e tyre, të indinjuar nga një qeveri e shurdhët, një qeveri e cila nuk i dëgjon qytetarët dhe nuk e shikon pamundësinë e tyre për të përballuar kostot e jetesës. Prej javësh tashmë produktet e shportës kanë pësuar rritje të pandalshme të çmimeve. 1 litër vaj sot është afro 1000 lekë të vjetër më shumë se 3 javë më parë, duke u tregtuar mesatarisht 330- 350 lekë të rinj për litër; buka masive është 50% më e shtrenjtë; mielli, orizi, sheqeri, makaronat dhe produktet e tjera bazike sot janë më të kushtueshme. Krahas efekteve të krizës mbarëbotërore, në Shqipëri lulëzon kudo abuzivizmi. Kjo gjë u dëshmuar qartazi me naftën, ku qeveria duke mosduruar presionin qytetar ndikoi drejtpërdrejt në uljen e çmimit të tregut të naftës, i cili u dëshmuar që ishte qartazi abuziv.

Ndërkohë, kur rritet çmimi në bursat ndërkombëtare, në Shqipëri ndodh menjëherë rritja e çmimit të naftës, e kundërta nuk ndodh thajse asnjëherë. Ja pra, kudo ka abuzivitet dhe qeveria e ka lenë jashtë çdo lloj ndikimi të saj, megjithatë larg asaj që kërkojnë dhe presin qytetarët, sepse rreth 50% e çmimit të naftës sot janë taksa, taksa të shtetit, dhe qeveria nuk ka marrë asnjë lloj veprimi konkret. Vendet fqinje tashmë kanë marrë masat e duhura duke reduktuar apo duke hequr taksat, ndërsa qeveria shqiptare refuzon të dëgjojë zërin e qytetarëve. Sot për naftën ne paguajmë: TVSH-në rreth 40 lekë për litër, akcizën 38 lekë, taksën e qarkullimit 27 lekë, rreth 18 lekë janë taksa të tjera, si ajo e karbonit, rilicencimit, skanimit e të tjera. Një qeveri, e cila nuk dëgjon qytetarët, patjetër që është një qeveri arrogante. Bordi i transparencës për naftën dhe për ushqimet nuk mund të kuptohet si diktat i shtetit mbi tregun e lirë, ku njerëzve, të lidhur me qeverinë, u lihet në dorë gjithçka.

Struktura të tilla, të denja për regjime si ky yni, duhet të kenë tjetër funksion e konceptim, atë të shmangies së abuzimeve me çmimet dhe të kenë në përbërje të tyre specialistë të fushave dhe jo ministra qeverie. Greqia para disa ditësh miratoi paketën e ndihmës me rreth 400 euro për familjet me të ardhura nën mesataren, ndërkohë Kryeministri juaj nxjerr në treg paketën boshe të rezistencës sociale. Them boshe, sepse përtej emrit të bukur, brenda saj nuk ka asnjë zgjidhje reale. Pensionistët duhet të rezistojnë me 3000 lekë shtesë në muaj, flasim vetëm për pensionistët që marrin pension të reduktuar, që janë invalidë apo për ata që jetojnë të vetmuar, sepse jo të gjithë do të jenë përfitues të kësaj vlere. Premtohet, nga ana tjetër, mosrritje e çmimit të energjisë për familjet dhe për bizneset e vogla. Te bizneset e vogla, në fakt, qeverisë suaj i ka dalë gënjeshtër që prej janarit të këtij viti, pasi mbi 1000 biznese të vogla, të lidhura me tensionin e mesëm, janë taksuar me një tarifë 70% më shumë, nga 11 lekë në 18,8 lekë për kilovat në orë.

Fermerët sot e blejnë naftën më shtrenjtë në raport me kolegët e tyre në rajon. Fermerët paguajnë me naftën dhe benzinën e pompës vaditëse taksën e qarkullimit. A ka kjo sens? Mendoj se jo. Falë TVSH-së së vendosur nga shteti ato i blejnë sot shumë më shtrenjtë plehurat kimike. Nitrati kushton rreth 130 mijë lekë për kuintal, dapi 140 mijë lekë për kuintal dhe ureja 120 mijë lekë të vjetra për kuintal. Unë nuk mendoj se ne shqiptarëve na duhen më shumë arsye për të protestuar. Sot fermerët në Divjakë dhe Lushnjë janë duke u dyndur në radhë në zyrat e aplikimit për përfitimin e fondeve nga AZHBR-ja, dhe ky është një turp, sepse vetëm të parët në listë përfitojnë, jo të gjithë fermerët që përmbushin kriteret, që janë përjashtuese, në gjykimin tim dhe në gjykimin e të gjithë atyre që kërkojnë dhe që duhet të përfitojnë patjetër. Ndryshe u premtua se do të ishin kriteret në fillim.